



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1170

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas (OE) "Sankos" Sh.p.k., kundër vendimit për dhënie të kontratës të "KOMUNA E GJAKOVËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore" me numër të prokurimit 632-24-9757-1-2-1, me 30/01/2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Sankos" Sh.p.k. me nr. 2024/1170, e datës 03/12/2024, kurse vendimi i AK "KOMUNA E GJAKOVËS" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore" me numër të prokurimit 632-24-9757-1-2-1,

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – "KOMUNA E GJAKOVËS", të datës 19.11.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimt të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 18.09.2024, “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore” me nr. të prokurimit: 632-24-9757-1-2-1. Ndërsa me datën 19.11.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin e ka shpërblyer me kontratë për aktivitetin e prokurimit të lart cekur. OE "EXIM JATEX" Sh.p.k.”- Gjakovë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - punë, vlera e parashikuar e kontratës: 25,000 €.

Me 25.11.2024, OE "Sankos" Sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 26.11.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.12.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Sankos" Sh.p.k, me nr. 2024/1170 për lidhur me aktivitetin “Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore” me nr. të prokurimit: 632-24-9757-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Sankos" Sh.p.k, janë parashtruar si në vijim:

Ne DT tek : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale askund , askund nuk përmendet ‘konformiteti’, ndërsa ne paramasen e çmimeve ne fund te tyre është e cekur se te gjitha materialet duhet te kenë një certifikate nga prodhuesi I njohur nderkombtarisht , pra kërkohet certifikata e jo deklarate konformiteti .Megjithatë edhe po te kërkohej një deklarate konformiteti , posedimi I certifikatës qe është dokument bazik ,tejkalon këtë kërkesë ngase deklarata e konformitetit bazohet ne te dhënat nga certifikata-raportet e testimit e jo anasjelltas .Ne si OE u kemi dërguar te gjitha certifikatat qe kane te bëjnë me këto produkte .AK ne përgjigje te kërkesës sonë për rishqyrtim , refuzon kërkesën tone dhe njëkohësisht anulon këtë aktivitet te prokurimit

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Sankos" Sh.p.k konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 67, dhe 70 te LPP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik "Sankos" Sh.p.k., me dt.25.11.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore” Lot 1: “Furnizim me uniforma verore dhe

dimërore për Brigadën e Zjarrëfiksëve’ , Nr. i prokurimit- 632-24-9757-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-052-121. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës. me datë 26.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse kjo ka qene kërkesë e FDT-së. për çka ju keni nënshkruar deklaratën në betim se jeni i përgjegjshëm dhe plotësoni kërkesat në FDT-ë. Vlerësimi i ofertave është bërë sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Nëse ju pretendoni se ISO 17050. është Standard për akreditimin e laboratorëve të tekstilit. atëherë ju këtë pikë është dashur ta atakoni para hapjes së tenderit duke kërkuar sqarime shtesë apo duke parashtruar kërkesë për rishqyrtim?

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 06.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1170/24, ndërsa me datë 19.12.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1170 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhen përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, dhe po ashtu OE nuk ka dhen përgjigje ne raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.-

Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Sankos" Sh.p.k, - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1170 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Oe ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimet të cilat janë ngritur nga operatori ankues, janë shqyrtuar nga eksperti dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1: OE ankues pretendon që: “Ne DT tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale askund, askund nuk përmendet ‘konformiteti’, ndërsa ne paramasen e çmimeve ne fund te tyre është e cekur se te gjitha materialet duhet te kenë një certifikate nga prodhuesi I

njohur ndërkombëtarisht, pra kërkohet certifikata e jo deklarate konformiteti. Megjithatë edhe po te kërkohej një deklarate konformiteti, posedimi i certifikatës që është dokument bazik, tejkalon këtë kërkesë ngase deklarata e konformitetit bazohet në të dhënat nga certifikata-raportet e testimit e jo anasjelltas. Nëse OE u kemi dërguar të gjitha certifikatat që kanë të bëjnë me këto produkte. AK në përgjigje të kërkesës sonë për rishqyrtim, refuzon kërkesën tonë dhe njëkohësisht anulon këtë aktivitet të prokurimit.”

Eksperti shqyrtues sqaron që një nga kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional ka qenë që operatorët pjesëmarrës të dorëzojnë edhe ISO 17050-1-Vlerësimi i konformitetit të furnizuesit dhe si dëshmi të dorëzohet licenca ISO valide-kopje. OE ankues në ofertën e tij, në pikën 10. Textile certifikatës të ofertës, ka dorëzuar disa certifikata, prej të cilave certifikata e cila është në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit sa i përket standardit ISO 17050 është certifikata me titull XMT-oeko-tex-certificate-2024.jpg, certifikatë e cila sipas mendimit të ekspertit shqyrtues është në përputhje me standardin ISO 17050-1 pasi që përmban elementet që i përkasin këtij standardi. Kjo certifikatë përfshinë deklaratën e përshtatshmërisë përmes të cilës thuhet se produkti është në përputhje me kërkesat përkatëse përfshirë dhe EN ISO 17050-1, po ashtu certifikata specifikon se produktet janë prodhuar duke përdorur materiale që janë certifikuar në përputhje me OEKO-TEX Standard 100 që është një standard për vlerësimin e sigurisë dhe përputhshmërisë së materialeve të përdorura në prodhimin e rrobave dhe produkteve tekstile.

Certifikata po ashtu përfshinë edhe një raport të testimit (nr.BJ015 224706.1) i cili është një tjetër element që shpesh kërkohet në kuadër të një certifikatë ISO 17050-1, pasi që dëshmon se produkti është testuar dhe ka kaluar testet e nevojshme për përputhshmërinë me standardet e aplikueshme. Mirëpo, duhet shtuar se pas analizimit të certifikatës është parë se kjo certifikatë është valide deri më datën 15/08/2024, datë e cila është para publikimit të njoftimit për kontratë dhe që tregon që në momentin e ofertimit nga ana e operatorit ankues, kjo certifikatë nuk ka qenë valide dhe nuk është parë asnjë dëshmi tjetër e cila është ofruar si vazhdim i validitetit të kësaj certifikate. Andaj në këtë pikë, eksperti vlerëson që nuk është përmbushur kriteri i FDT-së dhe se ky pretendim i ngritur është pjesërisht i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e

shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore” me nr. të prokurimit: 632-24-9757-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilave ja fal besimin, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Sankos" Sh.p.k te aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore” me nr. të prokurimit: 632-24-9757-1-2-1 të mbetet në fuqi vendimi i AK. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E GJAKOVËS” të datës 19.11.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ri Tender-Furnizim me uniforma verore dhe dimërore” me nr. të prokurimit: 632-24-9757-1-2-1, **dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.**

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatësthemelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " Sankos " Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: